



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 488/1 prot.

Tiranë më 8.6.2020

Lënda: Mendim mbi një projektivendim

Z. SANDËR LLESHAJ

MINISTËR I BRENDSHËM

Tiranë

I nderuar Z. Ministër,

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 374/6 Prot., datë 30.04.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për krijimin e bazës së të dhënave të “Sistemit për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES)” dhe shkëmbimin e të dhënave me “Sistemin Total të Menaxhimit (TIMS)”* (në vijim, *“Projektvendimi”*), në vijim gjeni mendimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Së pari, konstatojmë se Projektvendimi për krijimin e bazës së të dhënave *PISCES*, bazohet në ligjin nr. 42/2018 *“Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës”* (në vijim, *“Ligji nr. 42/2018”*), i cili parashikon bashkëpunimin e qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe mirëmbajtjen të gjitha pajisjeve elektronike të nevojshme për sistemin *PISCES*, si dhe trajnimin e personelit shqiptar për operimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi.

Nga ana tjetër, vërejmë se instrumenti i sipërpërmendur bazohet në dispozitat e ligjit nr. 72/2016 *“Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për shkëmbimin e informacionit për*

verifikimin e terrorizmit” (në vijim, “Ligji nr. 72/2016”) qëllimi i së cilës është nxitja e shkëmbimit të informacionit për verifikimin e terrorizmit, me qëllimin e vetëm të rritjes së përpjekjeve efikase në luftën kundër terrorizmit.

Rrjedhimisht, kuptojmë se ngritja dhe operimi i sistemit PISCES lidhet me zbatimin e detyrimeve të shtetit shqiptar në kuadër të marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 72/2016, për shkëmbimin e informacioneve në luftën e përbashkët kundra terrorizmit ndërkombëtar. Ndërsa Ligji nr. 42/2018 përcakton (vetëm) modalitetet tekniko-financiare për ngritjen, operimin dhe mirëmbajtjen e PISCES dhe jo detyrimin për konstituimin juridik të këtij sistemi.

Për këtë arsye, sugjerojmë që në Projektvendim të shtohet si bazë ligjore edhe ligji nr. 72/2016. Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo ndërhyrje do të qartësonte legjitimitetin e përpunimit të të dhënave personale në kuadër të PISCES.

Së dyti, në bazë pikës 5 të projektvendimit, konstatojmë se qëllimi i krijimit të sistemit PISCES është regjistrimi i hyrje-daljeve në Republikën e Shqipërisë, të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, në pikat e kalimit kufitar, ku ky sistem do të implementohet.

Nga ana tjetër, në vlerësimin tonë, qëllimi i krijimit të PISCES – i postuluar në Projektvendim rezulton thuajse i njëjtë me atë të Sistemit Total të Menaxhimit (TIMS)

Më tej, sipas pikës 9 të projektvendimit, PISCES do të popullohet me të dhëna të importuara nga TIMS (sipas kategorive, INAD/Deportiv/Refuzuar). Kështu, kuptojmë se i vetmi burim informacioni për PISCES do të jetë vetë TIMS.

Në këto kushte, sipas Projektvendimit, dy sistemet në fjalë rezultojnë të ndjekin të njëjtin qëllim përpunimi, si dhe të përpunojnë kategori të njëjta të dhënash personale (INAD/Deportiv/Refuzuar).

Për më tepër, dispozitat e Projektvendimit nuk parashikojnë që kategoritë në fjalë të të dhënave të ruhen vetëm në PISCES, nga momenti i popullimit të këtij sistemi e në vijim, pavarësisht se pika 7 e Projektvendimit shprehet se këto të dy sisteme janë plotësues për njëri-tjetrin.

Rrjedhimisht, për të shmangur pikëpyetjet që mund të ngrihen në lidhje me ekzistencën e njëkohëshme të dy sistemeve që ndjekin të njëjtin qëllim dhe përpunojnë kategori të njëjta të dhënash, Zyra e Komisionerit sugjeron që pika 5 e projektvendimit të riformulohet dhe të silllet në harmoni me pikën 1 të nenit 2 të marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 72/2016 (“*Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është nxitja e shkëmbimit të informacionit për verifikimin e terrorizmit, me qëllimin e vetëm të rritjes së përpjekjeve efikase në luftën kundër terrorizmit.*”).

Ky saktësim është i nevojshëm në respektim të zbatimit të parimeve të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së përpunimit parashikuar, përkatësisht, në gërmat “a” dhe “c” të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Së treti, nga interpretimi ynë i mësipërm lidhur me qëllimin dhe informacionin e njëjtë të të dy sistemeve (PISCES dhe TIMS) vlerësojmë se, në gjendjen aktuale, Projektvendimi rezulton të jetë në kundërshtim edhe me dispozitat e ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, i cili përmendet shprehimisht si bazë ligjore në Projektvendim. Konkretisht, pika 3 e nenit 4 e ligjit në fjalë përcakton se “Ndalohet krijimi i bazave të të dhënave shtetërore të veçanta për të njëjtin informacion ose qëllim.”.

Rrjedhimisht, mosrespektimi i dispozitës ligjore të sipërpërmendur, mund të sjellë përpunim të të dhënave personale në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në nenin 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Me plotësimin e kërkesave ligjore të parashtruara më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Projektvendimi do të konsiderohej në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

